

## V E N D I M

**Nr.12, datë 28.03.2019**


**Për miratimin e planit për auditimin e brendshëm  
të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin financiar 2019  
nga subjekti PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k.**

Në mbështetje të nenit 52, pika 1, shkronja “j” dhe nenit 63, pika 2 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, të nenit 18, pika 3 të “Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të Agjencisë nr. 24, datë 31.10.2018, si dhe të nenit 8, pika 3, shkronja “j” të vendimit të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, me propozim të Audituesit të Brendshëm të kontraktuar “PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k”, Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave,

---

## V E N D O S I:

1. Miratimin e planit të auditimit të brendshëm të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, për vitin financiar 2019 nga subjekti “PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Audituesi i Brendshëm për zbatimin e këtij vendimi.



## KËSHILLI DREJTUES

3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

**Sekretar**

Donald Duraj

**Kryetar**